



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.60 dt.24.04.1998

**“PER
VENDOSJEN E TARIFAVE TE SHERBIMIT NGA
INSPEKTORIATI VETERINAR”**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.24.04.1998, pasi shqyrtoi e miratoi materialin e paraqitur nga Drejtoritë e Veterinarisë dhe Ushqimit dhe ajo e Financës për vendosjen e tarifave të shërbimit nga Inspektoriati Veterinar i Bashkisë Tiranës, në zbatim të ligjeve Nr.7680, dt.09.08.1993 “Mbi Sistemin e Tatimeve në Republikën e Shqipërisë”, atij Nr.7777, dt.22.12.1993 “Për Sistemin e Taksave në Republikën e Shqipërisë”, ligjin Nr.7674, dt.23.02.1993 “Mbi Shërbimin dhe Inspektoriatin Veterinar” dhe ligjin Nr.7572, dt 10.06.1992“Për Organizimin dhe Funksonimin e Pushtetit Lokal”, e duke patur dhe rekomandimin zyrtar të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dërguar kësaj Bashkie me shkresën Nr.797, dt.04.04.1998;

VENDOSI

1. I gjithë aktiviteti i shërbimit veterinar të Bashkisë së Tiranës në Zyrë, doganë, thertore, frigoroferë e treg të kryhet kundrejt tarifës së shërbimit si më poshtë :
2. Për lëshimin e certifikatave të eksportit për lëkurë, bretkoca, kërmij, lesh apo kafshë shtëpiake (qen e mace) dhe produkte të tjera shtazore që marrin me vete qytetarët kur largohen nga Shqipëria, tarifat të jenë :

1.Për një çertifikatë ndërkombëtare për eksport lëkurësh deri në 20 Ton – 1.500 lekë dhe mbi 20 Ton – 2.000 lekë.

2.Për një çertifikatë ndërkombëtare për eksport bretkosa e kërmij tarifa të jetë 1.000 lekë.

3.Për një çertifikatë ndërkombëtare për eksport leshi 1.000 lekë.

4.Për një çertifikatë shoqërimi për qen e mace dhe produkte të tjera ushqimore shtazore për përdorim vetiak, tarifa të jetë 500 lekë.

3. Për shërbimin në doganë si kontrollin e dokumentacionit shoqërues si dhe vetë produktet e importuara, marrjen dhe dërgimin e mostrës për analizë laboratorike si dhe çertifikimin (dhënie e lejes së tregimit) për çdo makinë tarifa të jetë 500 lekë.

4. Për kontrollin periodik dhe lëshimin e raportit në fabrikat e sallamit dhe qumështit, për çdo raport tarifa të jetë 80 lekë.

5. Kontrolli i peshkut dhe gjallesave të tjera të detit për gjithë sasinë dhe lëshimin e çertifikatës për të lejuar konsumin e tyre, tarifa të jetë 100 lekë.

6. Për kontrollin e kafshëve para e pas therjes, vulosjen e mishit dhe pajisjen me raport veterinar, tarifatat të jenë :

1.Për një kre ka, lopë, buall e buallicë 200 lekë

2.Për një kre mëzat e mushqerë 120 lekë

3.Për një kre viç 100 lekë

4.Për një kre dash, dele, cjamin, dhi e derr 60 lekë

5.Për një krerë rurze, milor, ftuje e ftujak, qingj, kec e gic. 50 lekë

7. Këto tarifa do të aplikohen deri në fund të vitit 1998 si dhe në vazhdim për vitin 1999 dhe vitet pasuese në rast se nuk do të ndryshohen me ndonjë vendim tjetër të Këshillit Bashkiak ose të ndonjë tarife unike të ardhur nga dikasteret e tjera qendrore.
8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoritë e Veterinarisë dhe Ushqimit si dhe ajo e Financës së Bashkisë.
9. Vendimi ti bëhet i njohur Drejtorive si më sipër si dhe gjithë personave juridikë apo fizikë që kanë lidhje me zbatimin e tij. Njohjen e vendimit me personat e përmendur më sipër do ta bëjë Drejtoria e Veterinarisë dhe Ushqimit.
10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI